



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BELSH

KESHILLI BASHKIAK BELSH

Belsh më 05/ 08 / 2025

PROCES - VERBAL

“I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Belsh datë 05.08.2025”

Mbështetur në ligjin 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, njoftimi i këshilltarëve u bë nga sekretari i këshillit bashkiak dhe materialet e diskutuara janë dërguar zyrtarisht nëpërmjet e-mail.

➤ **Janë prezent në mbledhje 14 këshilltarë:**

1. Sami Uruçi
2. Erion Gjoshi
3. Erjon Qafa
4. Bujar Blloku
5. Nexhip Elezi
6. Gezim Gjoshi
7. Naime Ibrahimimi
8. Blerim Kuqja
9. Gazeli Hysa
10. Aleksandër Idrizi
11. Kujtim Dervishi
12. Aurjola Bezati
13. Enkeleda Kullolli
14. Ismail Paja

- Hapet mbledhja e këshillit bashkiak nga kryetari i këshillit.
- Propozon kryetari i këshillit që në rend dite të futet dhe ndihma ekonomike dhe miratohet me 11 vota pro.
- Kalojmë te pika nr.1 e rendit të ditës.
- A.Nipolli: Propozimi i projektit vjen si pasojë e kalimit të një periudhe 6-mujore,duke parë faktin e burimeve në momentin që ndodhemi.
- I.Paja: Do isha kundër kalimit nga privati te Green Belsh sh.a të shërbimit të pastrimit. Kush do ta menaxhojë shërbimin e pastrimit dhe numri i punonjësve?

- A.Nipolli: Ka një dokument për krijimin e Green Belsh.Është e drejta juaj të ankimoni vendimet e Bashkisë Belsh.
- B.Kuqja : Një shoqëri si Green Belsh nuk mund ti besohet shërbimi i pastrimit. Është organizuar një garë publike për përzgjedhjen e Green Belsh?
- A.Nipolli: Kostoja e pastrimit me Green Belsh do të jetë më e ulët se sa me privatin.
- B.Kuqja: A disponon Bashkia mjete për pastrimin?
- A.Nipolli:Bashkia disponon 2 mjete për të kryer shërbimin e pastrimit.
- K.Dervishi: Bashkia ka të gjithë përgjithesinë për shërbimin e pastrimit sidomos nëpërmjet Green Belsh.
- Gazeli Hysa: Sa para merrte kompania dhe pse u largua?
- A.Nipolli: Kompanisë i mbaroi kontrata.
- Hidhet në votim pika nr.1 e ndryshimit të buxhetit dhe miratohet me 11 vota pro.Voton kunder I.Paja,B.Kuqja dhe G.Hysa.
- Kalojmë te pika 2 ose b e ndryshimit në buxhet.
- Hidhet në votim pika b dhe miratohet me 11 vota pro dhe 3 kundër.
- Kalojmë te pika c e ndryshimit në buxhet.
- B.Kuqja: Mirë bëni që i blini pemët por mos i lini pa mirëmbajtje.
- Hidhet në votim pika c dhe miratohet me 14 vota pro.
- A. Nipolli : 3 pikat e radhës duhen përmbledhur.
- B.Kuqja: Cilët janë rrugët që do shtrohen?
- A.Nipolli: Seferan, Belsh Qëndër,etj...
- Sami Uruçi: Propozoj që të përfshihet rruga Hazis Dërvishi në investim dhe projektim.
- Hidhet në votim pika d e ndryshimit të buxhetit dhe miratohet me 12 vota pro dhe 2 abstenime. Abstenon B.Kuqja dhe G.Hysa.
- Hidhet në votim pika e dhe f dhe miratohet me 14 vota pro.
- Kalojmë te pika G dhe H ,shpenzime operative për administratën.
- K.Dervishi : Hidhet në votim pika G dhe H e ndryshimit të buxhetit dhe miratohet me 11 vota pro,2 kundër dhe 1 abstenim.
- Kalojmë te pika I dhe J ,Hidhen në votim dhe miratohen me 11 vota pro,1 kundër dhe 1 abstenim.
- Kalojmë te pika K dhe L dhe miratohen me 14 vota pro.
- Kalojmë te pika N dhe O. Hidhen në votim dhe miratohen me 13 vota pro,abstenon B.Kuqja.
- Kalojmë te pika nr. 2 e rendit të ditës për ndryshim kontrate me Eco-Elb.
- Hidhet në votim dhe miratohet me 11 vota pro dhe 3 kundër,përkatësisht B.Kuqja,I Paja dhe G.Hysa.
- Kalojmë te pika nr.3 e rendit të ditës.
- Mbron Ditjon Pepa: Janë përcaktuar zonat kadastrale.
- Hidhet në votim dhe miratohet me 11 vota pro pika nr.3 dhe janë tre abstenime, përkatësisht B.Kuqja ,G Hysa dhe I .Paja.
- Kalojmë te pika nr.4 për arsimin parauniversitar.
- Mbron O.Nipolli.
- Kujtim Dervishi: Janë bërë konsultime publike?
- O.Nipolli: Kemi bërë një takim me disa prindër.

- A.Bezati: Cili është konkluzioni?
- O.Nipolli: Mirëmbajtja e objekteve dhe ulja e klasave kolektive.
- A.Hysa : Duhet të krijojmë kushtet për rritjen e cilësisë së arsimit.
- B.Blloku: Në fshatin Gjolenë,çfarë sugjerimi keni për shkollën e këtij fshati?
- A.Hysa: Sugjerimi ynë është që të sistemohet shkolla në Kajan dhe të sigurohet transporti për nxënësit.
- Erjon Gjoshi: Nga konstatimi,ka fëmijë që nuk frekuentojnë shkollat dhe kopështet?
- O.Nipolli: Nuk ka fëmijë që nuk frekuenton shkollat dhe kopështet.
- B.Kuqja: Shtatori po vjen, si është infrastruktura e shkollave?
- O.Nipolli: Ka filluar puna për mirëmbajtjen e shkollave.
- S.Uruçi: Jeni pregatitur nëse ministria ja kalon Bashkisë arsmin parauniversitar?
- O.Nipolli: Janë bërë disa projekt pilote me disa Bashki dhe ne jemi të gatshëm.
- Hidhet në votim dhe miratohet me 13 vota pro dhe voton kundër A.Idrizi.
- Kalojmë te ndihma ekonomike.
- Kujtim Dervishi: Hidhet në votim ndihma ekonomike dhe miratohet me 14 vota pro.
- Kujtim Dervishi: I kam kërkuar zyrës që të sjellë p/vendim për mos pagesë në rast mungese në mbledhje sipas listë prezencës.
- Kundërshtohet nga shumica e këshilltarëve.
- **Mbyllet mbledhja e këshillit me 5 vendime të miratuara.**

Përgatiti :

SEKRETARI I KËSHILLIT

Endri PEPA